

VENDIM
Nr. 91, datë 4.7.2017

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PËR VITIN 2017, PËR OSHEE SHA**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, gjerat “a” dhe “e”; neni 75; nenit 110, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009; si dhe nenit 14 dhe 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 të shoqërisë OSHEE sh.a., të përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi:

- “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a., në shkresën me nr. 23480 Prot, datë 14.10.2016, ka paraqitur pranë ERE-s një studim lidhur me “Planin ekonomik-financiar për vitin 2017”.
 - Grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 62, datë 2.11.2016, të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga kompania.
 - Edhe mbas kërkesave të përsëritura të ERE-s, për plotësim dokumentacioni, është konstatuar paraqitje jo e plotë konform kërkesave të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, sipas nenit 11, pika 2, përkatësisht:
 - Raport lidhur me zbatimin e planit të vitit paraardhës.
 - Relacion shpjegues për investimet e planifikuara.
 - Paraqitje e kërkesave të nenit 10 (Planin e investimeve për të licencuarit në veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike).
 - Investimet janë paraqitur kryesisht me nocionet e buxhetimit dhe janë përdorur pak nocione teknike.
 - Koha e paraqitjes e pamjaftueshme për një analizë teknike.
 - Nevoja për saktësim të planit pas vendimit lidhur me tarifat 2017.
 - Nevoja për saktësimin e dokumentacionit sipas procedurave.
 - Nevoja për miratimin e një plani investimesh të bëshëm (fisibile).
- Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 për shoqërinë OSHEE sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin dhe personat e interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 - Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.
 - Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti